

**L I G J**  
**Nr.9431, datë 13.10.2005**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998**  
**“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Pika 1 e nenit 32/3 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 1,5 për qind.”.

**Neni 2**

Diferencat që mund të krijohen nga veprimi i këtij ligji, krahasuar me planifikimin e vitit 2005 për buxhetin e pushtetit vendor, do të kompensohen nga Ministria e Financave nëpërmjet grantit.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4682, datë 1.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,**  
**Alfred Moisiu**